



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 02.02.2026

V E N D I M

Nr.3, datë 02.02.2026

PËR

**“MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT “PROJEKT-UDHËZIM
PËR ZBATIMIN E RREGULLAVE TË INTERNETIT TË HAPUR””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 2.02.2026, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Projekt-Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur””

BAZA LIGJORE:

1. Pika 4 e Nenit 179 të Ligjit 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 54/2024);
2. Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr.21, datë 7.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti i përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Inspektimit për këshillim publik: "*Projekt-Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur*";
2. Projekt-Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;

V Ë R E N:

1. Ligji 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i cili hyri në fuqi më datë 20.12.2024 (duke shfuqizuar Ligjin 9918/2008), transponon në legjislacionin kombëtar Direktivën (EU) 2018/1972 të parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike" (në vijim EECC), dhe përmban një sërë përcaktimesh të reja në lidhje me të drejtat e përdoruesve fundorë të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, një pjesë e të cilave përbëjnë risi për tregun e komunikimeve elektronike dhe zbatimin e tyre nga ofruesit e shërbimeve duhet të kryhet në përputhje me aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP për zbatimin e ligjit të ri.
2. Përvec transpozimit të EECC, Nenet 177-179 të Ligjit 54/2024 përcaktojnë kuadrin kombëtar për aksesin në internet të hapur në Shqipëri, të përafëruar plotësisht me Nenet 3-5 të Rregullores (BE) 2015/2120¹, që përcaktojnë rregullat për aksesin në internet të hapur të detyrueshme për tu zbatuar në të gjitha vendet anëtare të BE-së. Pika 4 e Nenit 179 të Ligjit 54/2024, përcakton se AKEP pas konsultimit me palët e interesuara dhe bazuar në dokumentet përkatëse të BEREC-ut nxjerr udhëzime me qëllim zbatimin e qëndrueshëm të rregullave për internetin e hapur.
3. Në zbatim të pikës 4 e Nenit 179 të Ligjit 54/2024, AKEP ka përgatitur dokumentin për këshillim publik "*Projekt-Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur*" duke u bazuar në Udhëzimet më të fundit të BEREC mbi Zbatimin e Rregullores për Internetin të Hapur,² duke bërë përshtatjet e duhura të referencave të Rregullores BE 2015/2120 (Nenet 3-5) që përmban Udhëzimi i BEREC me referencat përkatëse në Ligjin 54/2024 (Nenet 177-179), si dhe në dokumenta të tjerë të BEREC të referuara në Shpjeguesin e dokumentit për këshillim publik (Shtojca 1 e dokumentit të Projekt-Udhëzimit).
4. Dokumenti "*Projekt-Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur*" përmban propozimin e AKEP për zbatimin e detyrimeve për internetin e hapur në Shqipëri, duke synuar të sigurojë:
 - interpretim të unifikuar të neneve 177–179 të Ligjit 54/2024 me qëllim zbatim të qëndrueshëm të tyre nga të gjithë ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet (ISP-të);
 - harmonizim të plotë të zbatimit të rregullave të internetit të hapur në Shqipëri me praktikën e BEREC-ut dhe zbatimin e tyre në vendet e BE-së;
 - promovim të disponueshmërisë së vazhdueshme të shërbimeve të aksesit në internet në baza jodiskriminuese dhe në nivele cilësore, që pasqyrojnë përparimet në teknologji;

¹ Regulation (EU) 2015/2120 of the European Parliament and of the Council of 25 November 2015 laying down measures concerning open internet access and retail charges for regulated intra-EU communications and amending Directive 2002/22/EC and Regulation (EU) No 531/2012.

² [BoR \(22\) 81 BEREC Guidelines on the Implementation of the Open Internet Regulation, 9 June 2022](#)

- mbrojtje më të mirë të konsumatorëve/përdoruesve fundorë të shërbimit të aksesit në internet;
 - transparencë dhe parashikueshmëri për ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet (ISP-të) në zbatimin e Neneve 177-179 të Ligjit 54/2024
 - këshillim me palët e interesuara për udhëzimet e përgatitura (pika 4 e Nenit 179), si dhe për mundësinë/alternativat e vendosjes së kërkesave minimale për cilësinë e shërbimit të aksesit në internet (pika 2 e Nenit 179) si dhe planin/afatet e propozuara për zbatimin e tyre.
5. Dokumenti për këshillim publik “*Projekt-Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur*”:
- është një dokument i rëndësishëm rregullator i përgatitur në kuadër të hartimit nga AKEP të akteve nënligjore përkatëse të nevojshme për zbatimin e ligjit 54/2024;
 - përmban propozimin e AKEP në lidhje me zbatimin e rregullave për internetin e hapur të përcaktuara në Nenet 177-179 të Ligjit 54/2024 nga të gjithë ofruesit e shërbimit të aksesit në internet në mënyrë të qëndrueshme;
 - nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të pikave 5 dhe 6 të nenit 141 të Ligjit 54/2024;
 - në përputhje me pikën 4 të Nenit 179 të Ligjit 54/2024, ka marrë parasysh udhëzimet, opinionet, rekomandimet, pozicionet e përbashkëta, praktikat më të mira e metodologjitë e BEREC-ut dhe vendimet përkatëse të Komisionit Evropian, duke u bazuar në Udhëzimet më të fundit të BEREC mbi Zbatimin e Rregullave për Internetin e Hapur (BoR (22) 81) dhe udhëzime të tjera të BEREC të referuara në dokument;
6. Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024, dhe Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr.21, datë 7.12.2021, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi do të nxirret për këshillim publik, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “*Projekt-Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur*”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Procedura e këshillimit publik të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit sipas pikës 3 më poshtë.

3. Ky Vendim dhe Dokumenti për këshillim publik “Projekt-Udhëzim për zbatimin e rregullave të internetit të hapur”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Inspektimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Bleron Dokle	Lorenc Bako	Armer Juka